VENDIM
Nr. 359, datë 16.6.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË URËS NË LEZHË DHE CAKTIMIN E BASHKISË LEZHË SI NJËSI ZBATUESE

(Ndryshuar me VKM nr. 662, datë 6.12.2023; me VKM nr. 342, datë 5.6.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në vlerën 294 682 990.44 (dyqind e nëntëdhjetë e katër milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë pikë dyzet e katër) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të urës në Lezhë.

2. Bashkisë Lezhë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 58 936 598 (pesëdhjetë e tetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të urës në Lezhë, në formën e transfertës së pakushtëzuar. Efekti financiar të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë, bazuar në rakordimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për këtë qëllim.

2/1. Bashkisë Lezhë, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i transferohet fondi në masën 78 879 186 (shtatëdhjetë e tetë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të urës në Lezhë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.

2/2. Bashkisë Lezhë, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, i transferohet fondi, në masën 151 838 708 (njëqind e pesëdhjetë e një milionë e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të urës në Lezhë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024.

3. Caktimin e Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese për rindërtimin e urës në Lezhë.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe